



2
0
2
4

BULETINI

SHTATOR



Marrëveshje bashkëpunimi në mes Komunës së Lipjanit dhe IADK

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z.Diamant Bytyqi, i shoqëruar nga bashkëpunëorët e tij, kanë pritur drejtorin e Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë- IADK Zenel Bunjaku, ku kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit “Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë”.

Qëllimi i projektit është që përmes aktiviteteve që do të zhvillohen, komunitetet që jetojnë në Komunën e Lipjanit të fuqizojnë aktivitetin e tyre bujqësor dhe ekonomik me qëllim gjenerimit të të ardhurave dhe punësim.



Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 29-të me radhë

Në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit, është mbajtur mbledhja e 29-të e Komitetit për Komunitete (KK), udhëhequr nga kryesuesi i komitetit z. Skender Bikliqi, janë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë kësaj mbledhje zyrtari kryesor financiar ka dhënë informatë lidhur me organizimin e dëgjimeve buxhetore të cilat janë zhvilluar së fundi për planifikimin e buxhetit 2025-2027 si dhe ka njoftuar te pranishmit për projektet që do të planifikohen në projekt buxhetin e vitit 2025-2027 tek komunitet jo shumicë në Komunën e Lipjanit.

Ndërsa, përfaqësuesit nga Zyra Lokale për Komunitet kanë shpalosur një informatë punët dhe aktivitetet e këtij sektori.

Në fund para mbylljes së mbledhjes anëtarët e KK-së shqyrtuan edhe disa çështje të ndryshme që lidhen direkt me jetën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit.



Drejtoresha e Administratës në Komunën e Lipjanit znj. Elmaze Behluli ka pritur në takim përfaqësueset e Organizatës GERMIN, ku së bashku kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me synim të angazhimit të Diasporës për avancimin e barazisë gjinore.

Qëllimi i këtij memorandum është krijimi i një bashkëpunimi në mes Komunës së Lipjanit dhe Organizatës GERMIN për të realizuar aktivitete të përbashkëta që promovojnë angazhimin e Diasporës për avancimin e barazisë gjinore.

Ky bashkëpunim synon të ndërtojë ura lidhëse mes qytetarëve të Lipjanit dhe anëtarëve të diasporës, duke nxitur ndërgjegjësimin dhe kontributin për çështjet e barazisë gjinore.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim Kryetarin e Bashkisë së Gramshit z. Besion Ajazi, së bashku me përfaqësuesit e KF. Gramshit nga Shqipëria.

Gjatë këtij takimi, Kryetari Ahmeti falënderoi Kryetarin Ajazi dhe përfaqësuesit e klubit për vizitën e tyre në Lipjan dhe për organizimin e ndeshjes miqësore me KF. Ulpiana 92.

“Me të vërtetë ndihem shumë mirë që në Lipjan organizohen ndeshje miqësore të këtij karakteri, të cilat jo vetëm që janë sportive, por njëkohësisht mundësojnë që sportistët të zhvillojnë aftësitë e tyre garuese dhe, në të njëjtën kohë, inkurajojnë zhvillimin e talenteve të reja në këtë sport,” tha Kryetari Ahmeti.

Ndeshja miqësore mes dy klubeve u zhvillua në stadiumin e qytetit të Lipjanit, duke krijuar një atmosferë sportive për të gjithë të pranishmit që e përcollën nga afër këtë ndeshje.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim z. Xhevat Lushi, së bashku me përfaqësuesit e organizatës holandeze CNVP dhe AZHR-Qender, me të cilët diskutoi për studimin e fizibilitetit të sistemit të ngrohjes së qytetit të Lipjanit.

Gjatë takimit, kryetari Ahmeti theksoi rëndësinë e këtij projekti, duke vlerësuar se një studim i tillë do të ofronte një zgjidhje të qëndrueshme për ngrohjen e qytetit, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët dhe mbrojtjen e mjedisit.

"Realizimi i një studimi të fizibilitetit për ngrohjen e qytetit të Lipjanit do të ishte i mirëpritur për ne dhe pa dyshim do të kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve tanë, si dhe në përmbushjen e kriterëve të Bashkimit Evropian për politikën e gjelbra", tha kryetari Ahmeti.

Komuna e Lipjanit është e angazhuar për një qytet më të gjelbër, ndërsa investimet në projekte që promovojnë energjinë e qëndrueshme janë objektiva të rëndësishme për zhvillimin e qytetit të Lipjanit.



Kryetari Ahmeti krenar për suksesin e FC Lipjani 01 në turneun FER PLEJ CUP në Ohër të Maqedonisë

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim grupmoshat e reja të shkollës së futbollit FC Lipjani 01, të cilët u shpallën nënkampionë në turneun FER PLEJ CUP që u mbajt në Ohër.

Gjatë takimit, kryetari Ahmeti përgëzoi të rinjtë për suksesin e arritur dhe përfaqësimin dinjitoz të qytetit të Lipjanit në këtë turne, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes për talentet e rinj.

"Ky është një rezultat që na bën krenarë dhe dëshmon për punën dhe përkushtimin e të rinjve tanë në sport. Mbështetja institucionale për këta talent nuk do të mungojë, pasi që ata vazhdimisht na bëjnë krenarë të gjithëve," tha kryetari Ahmeti.

Shkolla e futbollit FC Lipjani 01, me gjeneratën 2014, arriti të shpallet nënkampione e turneut FER PLEJ CUP, i organizuar në Ohër, Maqedoni.



Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes Komunës së Lipjanit dhe OJQ-së Advancing Together për zbatimin e projektit “Bëhu Partneri im për Mirëqenie”, i financuar nga UNMIK, në Komunën e Lipjanit janë shpërndarë pajisje të TI-së për të mbështetur aktivitetet Rinore të Kuvendit të të Rinjëve të Lipjanit nga AT dhe UNMIKU.



Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Pastrimit, Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Lipjanit organizoi një sërë aktivitete me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e ambientit.

Drejtori për Planifikim dhe Urbanizëm në Komunën e Lipjanit, z.Imri Semetishti theksoi rëndësinë e kësaj dite, duke nënvizuar se përpjekjet për ruajtjen e mjedisit duhet të jenë një angazhim i përditshëm i yni. Ai ftoi qytetarët që të kontribuojnë në krijimin e një ambienti të pastër dhe të shëndetshëm për komunitetin.

Aktivitetet vazhduan me një nismë praktike, ku nxënësit, qytetarët, operatori për mirëmbajtje dhe përfaqësues nga organizatat joqeveritare u angazhuan në pastrimin e hapësirave publike. Në përfundim të këtij aksioni, pjesëmarrësit shpërndanë letra informuese për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, duke synuar të përçojnë mesazhin se kujdesi ndaj natyrës është një përgjegjësi e përbashkët.



Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ka organizuar diskutim publik për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Lipjanit.

Me këtë rast, Kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Daut Azemi, theksoi rëndësinë e këtij dokumenti dhe shprehu mirënjohjen e tij për të gjithë pjesëmarrësit dhe kontribuesit në këtë proces, në mënyrë që ky dokument të jetë sa më i kompletuar dhe gjithëpërfshirës.

Po ashtu edhe Drejtori i Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, z. Shkelzen Hajdini, theksoi rëndësinë e strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal, me fokus në fushat kryesore që do të mbulojë ky dokument.

Gjatë takimit, të pranishmit patën mundësinë të diskutojnë dhe të shprehin shqyrtojnë draftin e strategjisë, duke kontribuar me ide dhe rekomandime që synojnë përmirësimin e këtij dokumenti tejet të rëndësishëm për pushtetin lokal.

Ky diskutim publik u organizua në bashkëpunim me OSBE-në.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, me rastin e ndërrimit të komandantit të LMT-së, ka pritur në zyrën e tij Kapitenin e KFOR-it, Korhan Aksoy, i shoqëruar nga përfaqësues të tjerë të KFOR-it Turk, të vendosur në Lipjan.

Me këtë rast, Kryetari Ahmeti i ka uruar punë të mbarë Kapitenit të ri, Korhan Aksoy, ndërsa Kolonelit Hasan Ozkilicasalan, i cili ka përfunduar mandatin, i ka uruar suksese në detyrat e tij të ardhshme.

Nga ana tjetër, Koloneli Hasan Ozkilicasalan është shprehur i kënaqur me bashkëpunimin me Komunën e Lipjanit, veçanërisht me Kryetarin Ahmeti, jo vetëm në sferën e sigurisë, por edhe në fusha të tjera me interes për qytetarët e Komunës së Lipjanit.



KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 29-të me radhë

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 29-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Pas prezantimeve dhe diskutimeve për secilën pikë, anëtarët e KPF-së aprovuan dhe rekomanduan të gjitha pikat për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më 26 shtator 2024.



Mbahet debati i dytë publik për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Lipjanit 2024-2029

Drejtorja për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Lipjanit në sallën e Kuvendit të Komunës ka mbajtur debatin e dytë të hapur publik me qytetarët dhe përfaqësuesit e bizneseve për të diskutuar Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Lipjanit 2024-2029.

Me këtë rast, Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, z. Valon Pacolli, tha se Komuna e Lipjanit është e interesuar që të ketë një strategji sa më të kompletuar dhe gjithëpërfshirëse, andaj kërkoi nga të pranishmit të jenë sa më aktivë gjatë fazës së konsultimit publik dhe të kontribuojnë me ide dhe rekomandime që kanë për synim avancimin e mëtejshëm të dokumentit.

Gjatë këtij takimi u dhanë propozime konkrete nga pjesëmarrësit lidhur me këtë dokument.



Kuvendi Komunal miraton buxhetin për vitin 2025-2027

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, udhëhequr nga Kryesuesi z. Daut Azemi, ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 33-të me radhë, në të cilën u shqyrtuan dhe u aprovuan pikat e rendit të ditës.

Fillimisht, këshilltarët kanë adresuar një mori pyetjesh për ekzekutivin komunal, ku edhe në të njëjtën kohë kanë marrë përgjigje nga vetë Kryetari z. Imri Ahmeti. Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, ka elaboruar Propozim Vendimin mbi aprovimin e buxhetit për vitet 2025-2027, ku theksoi se ky projektbuxhet do të ngërthejë në vete investime e projekte të shumta që kanë bazën tek qytetarët dhe i shërbejnë pikërisht atyre. Pas diskutimeve të zhvilluara lidhur me planifikimin e buxhetit, me shumicë votash u miratua ky buxhet.

Me vazhdimin e kësaj seance, Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti, ka prezantuar raportin e punës janar-qershor 2024 të zyrës së kryetarit dhe drejtorive komunale. Tutje u prezantua raporti i Performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2023, raporti monitorues për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit për periudhën 03.07.2023-03.07.2024, si dhe raporti i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e projektbuxhetit për vitin 2025-2027.



Nderohet dëshmori i kombit Arsim Zeqiri

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, i shoqëruar me bashkëpunëtorët, kanë bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë shtatores së Heroit të Kombit, Arsim Zeqiri, në fshatin Hallaq i Madh, me rastin e 26-vjetorit të rënies së tij.

Nënkryetari Bytyqi theksoi se Lipjani është krenar për heroin Arsim Zeqiri, i cili, edhe pse i ri, iu bashkua UÇK-së për të mbrojtur vendin dhe popullin e tij, në momentet kyçe, ai tregoi guxim dhe përkushtim të jashtëzakonshëm, duke dhënë jetën e tij për lirinë e Kosovës.




Nderohet dëshmori i kombit Arsim Zeqiri

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, i shoqëruar me bashkëpunëtorët, kanë bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë shtatores së Heroit të Kombit, Arsim Zeqiri, në fshatin Hallaq i Madh, me rastin e 26-vjetorit të rënies së tij.

Nënkryetari Bytyqi theksoi se Lipjani është krenar për heroin Arsim Zeqiri, i cili, edhe pse i ri, iu bashkua UÇK-së për të mbrojtur vendin dhe popullin e tij, në momentet kyçe, ai tregoi guxim dhe përkushtim të jashtëzakonshëm, duke dhënë jetën e tij për lirinë e Kosovës.

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë